



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, duke vendosur sipas kërkesës Nr.1-400-22943 të datës 07.05.2021 të Kryqit të Kuq të Kosovës dega në Lipjan, Kryetari i Komunes nxjerr:

**VENDIM  
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE**

**Neni 1**

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 500 € (pesëqind euro), Kryqit të Kuq të Kosovës dega në Lipjan sipas kërkesës së tyre Nr.1-400-22943 të datës 07.05.2021, për realizimin e shpërndarjes së ndihmave me pako ushqimore dhe higjienike për familjet që kanë nevojë urgjente në komunën e Lipjanit për shkak të gjendjes emergjente të krijuar nga pandemia COVIT-19.

**Neni 2**

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2021 pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhironlogarinë bankare të Kryqit të Kuq të Kosovës, në nr. 1719200019014408 në NLB bankë.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

**Neni 4**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryqit të Kuq të Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400-22943

Lipjan, më 11.05.2021

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

